

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE DENISA M.ÇELA
NR. 5275 REP.
NR. 742 KOL.



KONTRATE SHIT- BLERJE
(KUOTASH)

Ne Tirane, sot me date 10.12.2018 (dymije e tetembehjete), perpara meje Noterit Denisa M. ÇELA, me adrese ne Rrugen " Rreshit Çollaku", Pallati Shallvareve, Nr. 4, Tirane u paraqiten palet e meposhtme kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash.

SHITESI:

Znj. Blertha KOSTALLARI, atesia Ymer, shtetas shqiptar, lindur ne Burrel, me date 18.12.1980, dhe banuese ne adresen Rruga Durresi, Tirane, mbajtese e Leternjoftimit ID me nr. 031784059 dhe nr. Personal I 06218081 W , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar;

DHENESI I PELQIMIT/ BASHKESHORTI I SHITESSES

Z. Florian KOSTALLARI, atesia Vasillaq, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, banues po aty, adresa Rruga Durresit, mbajtes i Leternjoftimit ID nr. 027999195 dhe nr. Personal H 50610191 T, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar., (me poshte referuar bashkarisht si "Shitesit")

DHE

BLERESI:

Z. Nicola SALVADORI, atesia Renato, shtetas Italian, lindur ne Treviso, datelindja 29.08.1972, banues ne Treviso, pajisur me Pasaporte Italiane YB3218251, e vlefshme deri me 15.07.2028 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, (me poshte referuar si "Bleresi"), i asistuar ne perkthim nga njohesi i gjuhes Italiane, sic tregur ketu.

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t'i referohemi si "Pale", dhe bashkerisht do t'u referohemi si "Palet". Palet e lartpermendura per identitetin e te cileve u njoha nga dokumentet qe ata dorezuan, dhe sipas Vendimit te Asambleve te Shoqerise dhe sipas Ekstrakit te nxjerre nga QKB, kane tagra te plota per te vepruar dhe per te hyre ne kete Kontrate . Te dyja palet, personalisht me bene me dije, duke ushtruar vullnetin e tyre te lire, qe duan te lidhin kete marreveshje per Shit - Blerjen e kuotave ("Kontrata e Shit-Blerjes se Kuotave"), si me poshte vijon:

Te pergjithshme:

A. Shitesja eshte zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere 100,000 (njqind mije) Leke, perkatesisht zoteruese e 100% te kapitalit te shoqerise SYNTHESYSAL SHPK;

B. Shoqeria eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 07.12.2018, eshte pajisur me NUIS L 82407016 K, dhe ka si objekt kryesor : "Agjensi dhe/ose perfaqesuese tregtare ne lidhje me produkte te ndryshme, dhe ne vecanti me cdo produkt qe ka te beje me ndertimin, arredimin etj.....

Kapitali i Shoqerise eshte 100,000 LEK (njqind mije).

C. Shitesja deshiron te shese kuoten e saj, pra 100% te kapitalit te Shoqerise ne favor te Z. Nicola SALVADORI, dhe pas kalimit te kuotave Bleresi behet pronar i vetem duke disponuar ne masen 100% te kapitalit te Shoqerise "SYNTHESYSAL" SH.P.K.

D. Ne lidhje me kete transakcion jep pelqimin dhe bashkeshorti i Shiteses Z. Florian KOSTALLARI.

E. Ne perputhje me nenin 73 "Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave", te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise "Dispozitat e Pergjithshme per kontraten e shitjes", dhe ne pergjithesi te legjislacionit shqiptar ne fuqi, hartohet kontrata e shitjes se kuotave si me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Shitesi i kalon nepermjet shitblerjes se 100 % te kapitalit te zoteruar ne shoqeri si dhe te drejten e pronesis mbi 100% te kuotave, si dhe te gjitha te drejta te tjera te lidhura me pronesine mbi 100% te kuotes, duke e garantuar plotesisht titullin e pronesis te pa renduar me barre dhe Bleresi nga ana tjetere blen nga Shitesi kuoten kundrejt nje cmimi te percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

2.1. Çmimi i plote i shitjes se 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te kapitalit te Shoqerise eshte ne shumen prej 100,000 Lek (njqind mije).

Neni 3

Pagesa

3.1. Çmimi i shitjes se 100% te kapitalit te Shoqerise, eshte paguar nga Bleresi jashte kesaj zyre noteriale, dorazi dhe Shitesi deklaroi se ka perftuar cdo dhe te gjitha shumet e shitjes se kapitalit te Shoqerise.

Neni 4

Kalimi i pronesis se ligjshme mbi kuotat

4.1. Kalimi i pronesis se ligjshme mbi kuotat nga Shitesi te Bleresi do te kryhet menjehere me nenshkrimin e kontrates dhe depozitim e kontrates ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Garancite

Shitesi ne lidhje me kuotat qe zoteron, garanton Bleresin:

5.1. Se eshte pronar i kuotes te shitur e nuk ekzistojne te drejta te parablerjes, te blerjes, te marrjes ose te opsionit te ndonje personi te trete ne lidhje me kuotat e shitura.

5.2. Se e drejta per perfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara ne shoqerine do te mund te ushtrohet rregullisht.

5.3. Shoqeria nuk eshte pjesemarrrese direkte ose indirekte ne shoqeri te tjera dhe as nuk eshte e detyruar te bleje apo te mbaje pjesemarrje te tilla.

5.4. Te gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas dësimit të lidhjes së Kontrates së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme të shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të tjerë.

5.5. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate çdo dhe të gjitha të drejtat e Shitesit të lidhura me kapitalin e Shoqërisë transferohen në favor të Blerësit.

Neni 6

Regjistrimi

6.1. Regjistrimi i kalimit të kuotave nga Shitesi të Blerësit në Qendren Kombëtare të Biznesit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontrates.

Neni 7

Ligji i zbatueshëm

7.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

8.1. Palet do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarreveshje të lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Te ndryshme

9.1. Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandare të kësaj kontrate.

9.2. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve duke respektuar formën shkresore të noterizuar.

Për sa më sipër, ky akt hartohet nga unë noterja në 4 (katër) ekzemplare me vlerë të njëjtte ligjore dhe kuptimore, referuar vullnetit të palëve nënshkruese dhe ligjit, në përputhje të plote me Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Notarinë", vertetohet nënshkrimin e tyre, në praninë e përkatësve të treguar këtu.

Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteria deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET

SHITESJA

Znj. Blerta KOSTALLARI

Blerta Kostallari

Bashkeshorti i Shiteses

Z. Florian KOSTALLARI

Florian Kostallari

BLERESI

Z. Nicola SALVADORI

Nicola Salvadori

NOTERE PUBLIKE
DENISA M.ÇELA

Sokol Hoxha



NIPT: L 82407016 K
KAPITALI: 100,000 LEKE

**VENDIM I ORTAKUT
TE VETEM TE SHOQERISE
"SYNTHESYSAL" SH.P.K**

Sot, me **14 Dhjetor 2018**, ne seline e regjistruar te Shoqerise "SYNTHESYSAL" SH.P.K, me adrese ne Tirane Njesia Bashkiake nr. 9, Rruga "Mine Peza", Zona Kadastrale Nr. 8350, Nr. pasurie 4/6 -N/3, Hyrja 1, Apartamenti N/3, Shqiperi, Ortaku I vetemi Shoqerise **SYNTHESYSAL SH.P.K., Znj. BLERTA KOSTALLARI**

VENDOSI

1. Shitjen e Kuotave te Shoqerise "SYNTHESYSAL" SH.P.K., ne masen 100%, duke I tjetersuar keto kuota ne favor te Z. Nicola SALVADORI.
2. Miratimin e nenshkrimet te Kontrates se Shit - Blerjes se kuotave, duke kaluar pronesia e 100% te kapitalit te Shoqerise "SYNTHESYSAL" SH.P.K ne favor te Z. Nicola SALVADORI, duke u bere ky I fundit Ortak I Vetem I Shoqerise.

ORTAKU I VETEM

Znj. BLERTA KOSTALLARI

(emer, mbiemer, firme, vule)

Blertha Kostallari





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20181218105649343
Data e Rezultatit të Kerkimit: 18.12.2018
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 10:56:49AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-687-804
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

BLERTA YMER KOSTALLARI
SYNTHESYSAL SH.P.K.



Blerta Ymer Kostallari